1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare

- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME TEKNIKE

Posta Shqiptare sh.a është shoqëria më e madhe tregtare që operon në tregun e shërbimeve postare dhe financiare. Me një rrjet prej 384 zyrash të paisura me sistem alarmi në të gjithë Shqipërinë, Posta Shqiptare sh.a ofron shërbime postare e financiare në vend, duke i garantuar klientëve cilësi maksimale të shërbimeve, si dhe duke përmbushur më së miri sloganin Shpejt.Sigurt.Kudo!

1. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i kësaj procedure prokurimi është përmbushja e njëres prej pikave kryesore të misionit të shoqërisë që ka të bëjë me garantimin e sigurisë nëpërmjet reagimit me grupe të gatshme në raste rreziku.

Zhvillimi i kësaj procedure është një detyrim ligjor i Posta Shqiptare sh.a në zbatim të Ligjit “Për masat shtesë të sigurisë publike” si dhe Udhëzimit Nr. 633, datë 6.11.2018 “Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo të vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre” .

Konkretisht Posta Shqiptare sh.a me qëllim rritjen e sigurisë për asetet, objektet, mbrojtjen e jetës së klientëve dhe punonjësve të saj kërkon shërbime ruajtje si një kombinim i metodave të parashikuara në Udhëzimin Nr. 130 date 05.03.2018 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” ku parashikohet në Kreun V "Menaxhimi i Shërbimeve të SHPSF” pika 2 se:

Kontrata ndërmjet palëve përmban:

1. Mënyrën e ruajtjes së objektit me punonjës shërbimi, me pajisje sinjalizuese alarmi, me kamera sigurie.

Në zbatim të akteve ligjore të mësipërme, përcjellja e sinjaleve të alarmit bëhet përveçse në sallën operative qendrore të Postes Shqiptare sh.a në Tiranë, edhe në sallat operative të SHPSF-ve në çdo qark të R.SH.

Në pikën D të këtij Udhëzimi përcaktohet se:

Qendra e Kontrollit pajiset me sistem ndërlidhës telefonik (mobile e fiks) dhe radiokomunikim, të cilat bëjnë të mundur marrjen në kohë të sinjaleve të alarmit dhe sigurimin e pandërprerë të komunikimit pranë çdo objekti në ruajtje.

Në pikën E Organizimi i shërbimit në qendrën e kontrollit parashikohet se:

1. Qendra e Kontrollit realizon monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimin në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe marrjen dhe verifikimin e sinjaleve të alarmit (sinjal grabitje, sinjal zjarri) ...

2. Qendra e Kontrollit me marrjen e njoftimit apo të sinjalit të alarmit dërgon menjëherë grupin e verifikimit të sinjaleve, duke i sqaruar situatën dhe vendodhjen e objektit si dhe njofton për ndihmë dhe ndërhyrje emergjente shërbimet e specializuara të institucioneve përkatëse.

3. Grupi i verifikimit të sinjaleve, nëse konstaton se në objektin në ruajtje ka ndodhur një ngjaje kriminale merr masa për ruajtjen dhe sigurimin e vendit të ngjarjes, për ndërprerjen e mëtejshme të veprimtarisë kriminale, dhënien e ndihmës së parë viktimave .

Me qëllim realizimin me sukses të procedurës, kontratës dhe përmbushjen e nevojave të sigurisë shërbimi i kërkuar është si më poshtë:

1. Shërbimi i marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit dhe reagimit me grup të gatshëm në të gjitha filialet dhe deget e Posta Shqiptare sh.a.

Shoqëria e sigurisë mban përgjegjësi pas aktivizimit të sistemit të alarmit. Me marrjen e sinjalit të alarmit, SHPSF, duhet të dërgojë menjëherë në vendngjarje grupin e gatshëm për verifikimin dhe ndërhyrjen sipas ligjit në rast se është nevoja.

Në Zyrat Postare Qytet, koha e ndërhyrjes dhe e veprimit të Grupit të Gatshëm në vendngjarje të jetë nga 2 (dy minuta) deri në 6 (gjashtë minuta).

Në Zyrat Postare zona Rurale (Fshat) koha e ndërhyrjes dhe e veprimit të Grupit të Gatshëm në vendngjarje të jetë nga 15 (pesëmbëdhjet minuta) deri në 30 (tridhjetë minuta), në varësi të distancës nga Qyteti më i afërt.

Veprimet e Grupit të Gatshëm në vendngjarje do të jenë në mbrojtje të jetës së punonjësve, të vlerave monetare e të aseteve të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., duke neutralizuar, bllokuar, ndjekur dhe shtrënguar fizikisht elementin kriminal, por pa tejkaluar në asnjë rast, të drejtat dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin Ligjin nr.75/2014.

Veprimet operative dhe përdorimi i armëve luftarake do të kryhen në përputhje me Ligjin nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Ligjin nr.72, datë 10.07.2014, “Për përdorimin e armëve të zjarrit”.

Përbërja e Grupit të Gatshëm në vendngjarje të jetë jo më pak se 2 (dy) persona, punonjës të këtij shërbimi të pajisur me uniformën e shërbimit me logon e Operatorit, armatim, armë brezi ose armë krahu shoqëruar me kompletin e municionit luftarak të tyre dhe me pajimet speciale të kryerjes së këtyre shërbimeve dhe të jenë të pajisur me automjete, motorr ose automjet me logon përkatëse të kompanisë që mbulon këtë shërbim.

SH.P.S.F-ja, të disponojë qendër operative me shërbim 24 orësh, për marrjen dhe verifikimin me grup të gatshëm, të sinjaleve të sistemit të alarmit të instaluar në objektet e Postës Shqiptare sh a.

SH.P.S.F-ja, të ketë të instaluar në qendrën operative të saj, qendrën e radiondërlidhjes.

Në qendrën operative, përveç pajisjeve të mësipërme, të ketë të instaluar qendër kompjuterike për marrjen e sinjaleve të sistemeve të alarmit në rrugë valore.

Në qendrën kompjuterike të disponojë: antenë marrëse me pajisjen përkatëse, kompjuter (njësi+monitor), program kompjuterik për marrjen e sinjaleve të alarmit (të instaluar në

kompjuter dhe funksional me objekte të tjerë), printer për printim automatik dhe pa ndërprerje të çdo ngjarjeje (sinjali alarmi).

Të sigurojë funksionimin 24 orë dhe mbajtjen në gadishmëri, të pajisjeve radio të instaluar në sistemet tona të alarmit, si dhe të qendrës kompjuterike.

Të sigurojë printim permanent të ngjarjeve (sinjaleve të alarmit) në qendrën kompjuterike dhe të vendosë në dispozicion të Postës, kur kjo e sheh të arsyeshme.

Përgjegjësit e objekteve garantojnë aktivizimin dhe caktivizimin e alarmit në momentin e mbylljes dhe hapjes së objektit.

Shoqëria e sigurisë mban përgjegjësi për të gjitha dëmet e shkaktuara materiale dhe financiare pas aktivizimit të sistemit të alarmit në rast se vjedhja apo dëmtimi i materialeve në objektin e siguruar ka ardhur si pasojë e neglizhencës së shërbimeve të kësaj shoqërie (pas ardhjes së sinjalit të alarmit në monitor si pasojë e mosvlerësimit dhe vonësës në verifikim).

LISTAT:

Afatet e ekzekutimit : **Shërbimi kërkohet të realizohet:** Për një periudhë 1 (një) vit kalendarik, që fillon pas përfundimit të kontratës që është në fuqi.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

“Shërbimi i marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit dhe reagimi me grup të gatshëm në të gjitha Filialet e Degët, e Postës Shqiptare”

Artikulli	Përshkrimi i shërbimit
1.	Shërbimi i marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit dhe reagimit me grup të gatshëm në Filialet, Degët dhe Zyrat Postare.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj.

Shërbimi kërkohet të realizohet: Afati i ofrimit të shërbimit do të jetë për 12 (dymbëdhjetë) muaj nga momenti i fillimit të ofrimit të shërbimit.

Rrjedhimisht, formulari ofertës ekonomike për këtë procedurë do të ndryshojë si më poshtë:

Shpërndarja dhe instalimi :

Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi për 12 Muaj	Çmimi Total	Afati
1.	Shërbimi i marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit.	384			12 muaj
	T O T A L I	384			

Shuma e përgjithshme e zyrave postare të pajisura me sisteme alarmi:

- A. SH.R.S.F-ja, të disponojë qendër operative me shërbim 24 orësh, për marrjen dhe verifikimin me grup të gatshëm, të sinjaleve të sistemit të alarmit të instaluar në objektet e Postës Shqiptare sh a.
- B. SH.R.S.F-ja, të ketë të instaluar në qendrën operative të saj, qendrën e radiondërlidhjes.
- C. Në qendrën operative, përveç pajisjeve të mësipërme, të ketë të instaluar qendër kompjuterike për marrjen e sinjaleve të sistemeve të alarmit në rrugë valore.
- D. Në qendrën kompjuterike të disponojë: antenë marrëse me pajisjen përkatëse, kompjuter (njësi+monitor), program kompjuterik për marrjen e sinjaleve të alarmit (**të instaluar në kompjuter dhe funksional me objekte të tjerë**), printer për printim automatik dhe pa ndërprerje të çdo ngjarjeje (sinjali alarmi).
- E. Të sigurojë funksionimin 24 orë dhe mbajtjen në gadishmëri, të pajisjeve radio të instaluar në sistemet tona të alarmit, si dhe të qendrës kompjuterike.
- F. Të sigurojë printim permanent të ngjarjeve (sinjaleve të alarmit) në qendrën kompjuterike dhe të vendosë në dispozicion të Postës, kur kjo e shihet të arsyeshme.
- G. SH.R.S.F-ja, të ketë grup të gatshëm 24 orë, të paisur me automjet të posaçëm, armatim personal, dhe pajisje radiondërlidhje gjithçka sipas ligjit nr ligj Nr. 75/2014 “ Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Udhëzimit nr.130 datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike” të atashuar pranë qendrës së firmës, dhe në Filialet Postës për të ndërhyrë në kohë sa më të shpejtë në çdo Filial, Degë apo zyrë të Posta Shqiptare sh a.
- H. SH.R.S.F-ja, të ketë sistem ndërlidhje eficient në të gjithë territorin ku zhvillon aktivitetin Posta Shqiptare sh.a

- I. Veprimet e Grupit të Gatshëm në vendngjarje do të jenë në mbrojtje të jetës së punonjësve, të vlerave monetare e të aseteve të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., duke neutralizuar, bllokuar, ndjekur e ndaluar (*arestuar*) elementin kriminal. Veprimet operative dhe përdorimi i armëve luftarake do të kryhen në përputhje me Ligjin nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Ligjin nr.72, datë 10.07.2014, “Për përdorimin e armëve të zjarrit”.

Shuma e përgjithshme e zyrave postare të pajisura me sisteme alarmi

NR Ambi	N/R	FILIALI FIER	SISTEM ALARMI (S.A)
1	1	Fier Qendër	1
2	2	Zp Fier 1	1
3	3	Zp Fier 2	1
4	4	Zp Fier 3	1
5	5	Zp Fier 4	1
6	6	Zp Verri-Mbrostar	1
7	7	Zp Libofsh	1
8	8	Zp Fermë – Grecalli	1
9	9	Zp Dermenas	1
10	10	Zp Povelc	1
11	11	Zp Seman	1
12	12	Zp Levan	1
13	13	Zp Levan 1	1
14	14	Zp Frakull	1
15	15	Zp Cakran	1
16	16	Zp Portëz	1
17	17	Zp Patos Pensione	1
18	18	Zp Zharrëz	1
19	19	Zp Roskovec	1
20	20	Zp Suk	1
21	21	Zp Strum	1
22	22	Zp Ballsh	1
23	23	Zp Ballsh Pensone	1
24	24	Zp Aranitas	1
25	25	Zp Hekal	1
26	26	Zp Greshicë	1
27	27	Zp Fratar	1
		TOTALI	27
	N/R	SHKODER	SISTEM ALARMI (S.A)

28	1	Shkodër Qendër	1
29	2	Zp Shkodër 3	1
30	3	Zp Shkodër 4	1
31	4	Zp Shkodër 5	1
32	5	Zp Shkodër 9	1
33	6	Zp Shkodër 12	1
34	7	Koplik Administrate	1
35	8	Zp Koplik Qendër	1
36	9	Pukë Administratë	1
37	10	Zp Pukë Qendër	1
38	11	Zp Bushat	1
39	12	Zp Bajzë	1
40	13	Zp Vau Dejës	1
41	14	Zp Hani-Hotit	1
42	15	Zp Dobraç	1
43	16	Zp Fushë Arrëz	1
44	17	Zp Velipojë	1
45	18	Zp Dajç	1
46	19	Zp Mjedë	1
47	20	Zp Guri Zi	1
48	21	Zp Oblik	1
49	22	Zp Pukë 1	1
50	23	Zp Pukë 2	1
		TOTALI	23
	N/R	FILIALI BERAT	SISTEM ALARMI (S.A)
51	1	Berat Qendër	1
52	2	Zp Berat 1	1
53	3	Zp Berat 2	1
54	4	Zp Berat 4	1
55	5	Zp Berat 6 Uznovë	1
56	6	Zp Ura Vajgurore	1
57	7	Zp Poshnje	1
58	8	Zp Kutalli	1
59	9	Zp Lapardha	1
60	10	Zp Otlak	1
61	11	Zp Lumas	1
62	12	Zp Mbrakull	1
63	13	Zp Velabisht	1
64	14	Zp Sinjë	1
65	15	Kuçovë Qendër	1
66	16	Zp Kuçovë Qendër e Re	1

67	17	Zp Kuçovë 2	1
68	18	Zp Kozare	1
69	19	Zp Perondi	1
70	20	Corovodë Qendër	1
71	21	Zp Polican 1	1
72	22	Zp Polican 2	1
		TOTALI	22
	N/R	FILIALI LEZHE	SISTEM ALARMI (S.A)
73	1	Lezhë Qendër	1
74	2	Zp Lezha 1	1
75	3	Zp Shëngjin	1
76	4	Zp Balldre	1
77	5	Zp Blinisht	1
78	6	Zp Dajç	1
79	7	Zp Kallmet	1
80	8	Zp Rrilë	1
81	9	Zp Zejmen	1
82	10	Zp Shënkoll	1
83	11	Qendër Laç	1
84	12	Përpunimi Laç	1
85	13	Zp Laç 2 Pensione	1
86	14	Zp Mamurras	1
87	15	Zp Milot	1
88	16	Zp Fushë Kuqe	1
89	17	Qendër Rrëshen	1
90	18	Dega Administrat	1
91	19	Zp Rubik	1
		TOTALI	19
	N/R	FILIALI KUKES	SISTEM ALARMI (S.A)
92	1	Administrata	1
93	2	Kukës Qendër	1
94	3	Zp Kukës 1	1
95	4	Zp Kukës 2	1
96	5	Zp Shtiqen	1
97	6	Zp Bicaj	1
98	7	Zp Shemri	1
99	8	Zp Shishtavec	1
100	9	Zp Has	1
101	10	Zp Krumë	1
102	11	Zp Golaj	1

103	12	Bajram Curri Qendër	1
104	13	Zp Bajram Curri 1	1
105	14	Zp Tropojë e Vjetër	1
106	15	Zp Lekbibaj	1
		TOTAL	15
	N/R	FILIALI VLORE	SISTEM ALARMI (S.A)
107	1	Vlora Qendër	1
108	2	Zp Vlora 1	1
109	3	Zp Vlora 2	1
110	4	Zp Vlora 3	1
111	5	Zp Vlora 4	1
112	6	Zp Vlora 5	1
113	7	Zp Skelë	1
114	8	Zp Uji Ftohtë	1
115	9	Zp Novoselë	1
116	10	Zp Selenic	1
117	11	Zp Nartë	1
118	12	Zp Babicë	1
119	13	Zp Kotë	1
120	14	Zp Armen	1
121	15	Zp Sevaster	1
122	16	Zp Vllahinë	1
123	17	Zp Gjorëm	1
124	18	Zp Trevllazer	1
125	19	Zp Shushicë	1
126	20	Zp Qeparo	1
127	21	Zp Orikum	1
128	22	Zp Himarë	1
129	23	Zp Dhërmi	1
		TOTAL	23
	N/R	FILIALI ELBASAN	SISTEM ALARMI (S.A)
130	1	Elbasan Qendër	1
131	2	Zp Elbasan 1	1
132	3	Zp Elbasan 2	1
133	4	Zp Elbasan 3 e 3/1	1
134	5	Zp Elbasan 5	1
135	6	0Zp Elbasan 5/1	1
136	7	Përpunimi	1
137	8	Zp Cërrik Pensione	1
138	9	Zp Cërrik 1	1
139	10	Zp Belsh	1
140	11	Zp Labinot Fushë	1

141	12	Zp Gostimë	1
142	13	Zp Shtermen	1
143	14	Zp Klos	1
144	15	Zp Mollas	1
145	16	Zp Gjinar	1
146	17	Zp Zavalinë	1
147	18	Zp Labinot Mal	1
148	19	Zp Mlizë	1
149	20	Zp Shushicë	1
150	21	Zp Shirgjan	1
151	22	Zp Gjergjan	1
152	23	Zp Tregan	1
153	24	Zp Shales	1
154	25	Zp Kajan	1
155	26	Zp Grekan	1
156	27	Zp Fierze	1
157	28	Zp Bradashesh	1
158	29	Zp Funar	1
159	30	Zp Gracen	1
160	31	Zp Paper	1
		TOTAL	31
	N/R	FILIALI ELBASAN/Librazhd	SISTEM ALARMI (S.A)
161	1	Librazhd Qendër	1
162	2	Zp Librazhd 2 (pensione)	1
163	3	Zp Prenjas 1	1
164	4	Zp Prenjas 2(pensione)	1
165	5	Zp Hotolisht	1
166	6	Zp Polis	1
167	7	Zp Lunik	1
		TOTAL	7
	N/R	FILIALI ELBASAN/Gramsh	SISTEM ALARMI (S.A)
168	1	Gramsh Qendër	1
169	2	Zp Gramsh Pensione	1
170	3	Zp Tunje	1
171	4	Zp Kodovjat	1
		TOTAL	4
	N/R	FILIALI ELBASAN/Peqin	SISTEM ALARMI (S.A)
172	1	Peqin Qendër	1
173	2	Zp Përparim	1
174	3	Zp Pajovë	1
175	4	Zp Shezë	1

176	5	Zp Gjocaj	1
177	6	Zp Karinë	1
		TOTAL	6
		TOTAL	48
	N/R	FILIALI MAT	SISTEM ALARMI (S.A)
178	1	Burrel Qendër	1
179	2	Zp Burrel 1	1
180	3	Zp Ulëz	1
181	4	Zp Baz	1
182	5	Zp Komsî	1
183	6	Zp Lis	1
184	7	Zp Suç	1
185	8	Zp Klos	1
186	9	Bulqizë Qendër	1
187	10	Zp Bulqizë 1	1
188	11	Zp Fushë Bulqizë	1
189	12	Zp Shupenzë	1
190	13	Peshkopi Qendër	1
191	14	Zp Peshkopi 1	1
192	15	Zp Maqellarë	1
193	16	Zp Doganë Qafë Bllatë	1
194	17	Zp Kastriot	1
195	18	Zp Muhurr	1
196	19	Zp Ostren	1
		TOTALI	19
	N/R	FILIALI LUSHNJE	SISTEM ALARMI (S.A)
197	1	Lushnje Qendët	1
198	2	Zp Lushnja 1	1
199	3	Zp Dushk	1
200	4	Zp Cerme	1
201	5	Zp Divjakë	1
202	6	Zp Remas	1
203	7	Zp Gradisht	1
204	8	Zp Kemishtaj	1
205	9	Zp Gorre	1
206	10	Zp Kolonje	1
207	11	Zp Bubullime	1
208	12	Zp Krutje	1
209	13	Zp Allkaj	1
210	14	Zp Fiershegan	1

211	15	Zp Kashtebardhe	1
212	16	Zp Karbunare e Madhe	1
213	17	Zp Karbunare e Vogel	1
214	18	Zp Ballagat	1
215	19	Zp Hyzgjokaj	1
216	20	Zp Golem	1
217	21	Zp Grabian	1
218	22	Zp Plug	1
		TOTALI	22
	N/R	FILIALI GJIROKASTER	SISTEM ALARMI (S.A)
219	1	Gjirokastër Qendër	1
220	2	Zp Gjirokastra 1	1
221	3	Zp Libohovë	1
222	4	Zp Lazarat	1
223	5	Zp Dervician	1
224	6	Zp Sofratike	1
225	7	Zp Jergucat	1
226	8	Zp Vrisera	1
227	9	Zp Kardhiq	1
228	10	Zp Asim Zeneli	1
229	11	Tepelenë Administrat	1
230	12	Zp Tepelenë Pensione	1
231	13	Zp Memaliaj	1
232	14	Përmet Qendër	1
233	15	Zp Këlcyrë	1
		TOTALI	15
	N/R	FILIALI KORÇE	SISTEM ALARMI (S.A)
234	1	Qendër Korçë	1
235	2	Zp Korçë 1	1
236	3	Zp Korçë 2	1
237	4	Zp Korçë 3	1
238	5	Zp Korçë 4	1
239	6	Zp Buçimas	1
240	7	Zp Cerrave	1
241	8	Zp Dishnicë	1
242	9	Pogradec Qendër	1
243	10	Zp Pogradec 1	1
244	11	Zp Pogradec 2	1
245	12	Zp Bulgarec	1
246	13	Zp Voskop	1
247	14	Zp Voskopoje	1

248	15	Zp Lumalas	1
249	16	Zp Drenovë	1
250	17	Zp Maliq	1
251	18	Zp Vreshtas	1
252	19	Zp Pojan	1
253	20	Zp Pirc	1
254	21	Zp Plase	1
255	22	Zp Erseke	1
256	23	Zp Leskovik	1
257	24	Zp Bilisht	1
258	25	Zp Hociht	1
		TOTAL	25
	N/R	FILIALI SARANDE	SISTEM ALARMI (S.A)
259	1	Sarande Qender	1
260	2	Zp Sarandë 1	1
261	3	Zp Delvinë	1
262	4	Zp Konispol	1
263	5	Zp Ksamil	1
264	6	Zp Xarre	1
265	7	Zp Livadhja	1
266	8	Zp Gjashtë	1
267	9	Zp Aliko	1
268	10	Zp Borsh	1
269	11	Zp Piqeras	1
270	12	Zp Lukovë	1
271	13	Zp Finiq	1
272	14	Zp Vergo	1
273	15	Zp Stjar	1
274	16	Zp Markat	1
275	17	Zp Shales	1
276	18	Zp Memoraq	1
277	19	Zp Mesopotam	1
		TOTALI	19
	N/R	FILIALI DURRES	SISTEM ALARMI (S.A)
278	1	Durrës Qendër	1
279	2	Zp Durrës 1	1
280	3	Zp Durres 2	1
281	4	Zp Durres 3	1
282	5	Zp Durres 4	1
283	6	Zp Durres 5	1
284	7	Zp Durrës 7	1
285	8	Zp Durres 8	1

286	9	Zp Shkozet	1
287	10	Zp Spitalle	1
288	11	Zp Plazh	1
289	12	Kruje Qender	1
290	13	Zp Fushe Kruje 1	1
291	14	Zp Fushe Kruje 2	1
292	15	Shijak Qender	1
293	16	Zp Shijak 1	1
294	17	Zp Sukth	1
295	18	Zp Manz	1
296	19	Zp Rrashbull	1
297	20	Zp Maminas	1
298	21	Zp Katun i Ri	1
299	22	Zp Xhafzotaj	1
300	23	Zp Drac	1
301	24	Zp Ishem	1
302	25	Zp Gjepalaj	1
303	26	Zp 4 Rruget	1
304	27	Zp Nikel	1
305	28	Zp Bubq	1
306	29	Zp Thumane	1
		TOTALI	29
	N/R	FILIALI TIRANE	SISTEM ALARMI (S.A)
307	1	Zp Nr.1	1
308	2	Zp Nr.2	1
309	3	Zp Nr.3	1
310	4	Zp Nr.4	1
311	5	Zp Nr.5	1
312	6	Zp Nr.5/1	1
313	7	Zp Nr.6	1
314	8	Zp Nr.7	1
315	9	Zp Nr.8	1
316	10	Zp Nr.8/1	1
317	11	Zp Nr.9	1
318	12	Zp Nr.10	1
319	13	Zp Nr.11	1
320	14	Zp Nr.12	1
321	15	Zp Nr.13	1
322	16	Zp Nr.14	1
323	17	Zp Nr.15	1
324	18	Zp Nr.16	1
325	19	Zp Nr.17	1

326	20	Zp Nr.18	1
327	21	Zp Nr.19	1
328	22	Filatelia	1
329	23	Zp Nr.21	1
330	24	Zp Nr.22	1
331	25	Zp Nr.23	1
332	26	Zp Nr.24	1
333	27	Zp Nr.26	1
334	28	Zp Nr.27	1
335	29	Zp Nr.28	1
336	30	Zp Nr.29	1
337	31	Zp Nr.30	1
338	32	Zp Nr.31	1
339	33	Zp Nr.32	1
340	34	Zp Nr.33	1
341	35	Zp Nr.46	1
342	36	Zp Nr.50	1
343	37	Zp Selitë	1
344	38	Zp Babrru	1
345	39	Zp Priskë	1
346	40	Zp Shëngjergj	1
347	41	Zp Baldushk	1
348	42	Zp Petrelë	1
349	43	Zp Bërzhitë	1
350	44	Zp Krrabë	1
351	45	Zp Farkë	1
352	46	Zp Kashar	1
353	47	Zp Ndroq	1
354	48	Zp Pezë	1
355	49	Zp Mëzez	1
356	50	Zp Vaqarr	1
357	51	Zp Yzberisht	1
358	52	Zp Prezë	1
359	53	Zp Bathore	1
360	54	Zp Zall Herr	1
361	55	Zp Domje	1
362	56	Zp Vorë	1
363	57	Zp Sauk	1
364	58	Zp Zallbatar	1
365	59	Kavaj Qendër	1
366	60	Zp Kavaja 1	1
367	61	Zp Rrogozhinë	1

368	62	Zp Synej	1
369	63	Zp Golem	1
370	64	Zp Lekaj	1
371	65	Zp Gos	1
372	66	Zp Helmës	1
373	67	Zp Luz i Vogël	1
374	68	Zp Kryevish	1
375	69	ZpNr.8/2	1
376	70	EMSI	1
377	71	Shpërndarsia	1
378	72	Zp Nr.34	1
379	73	Zp Instituti Bujqsor	1
380	74	Zp Nr.20	1
381	75	Zp Sinaballaj	1
		TOTALI	75
	N/R	FILIALI TRANZIT	SISTEM ALARMI (S.A)
382	1	Qëndra Tranzite	1
		TOTALI	1
383		FILIALI HIBRID MAIL	
			1
		TOTALI	1
	N/R	DR/PERGJITHSHME	SISTEM ALARMI (S.A)
384	1	ADMINISTRATA	1
		TOTALI	1
		SHUMA TOTALE	384

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, AK do të lejojë faturimin individual nga secili prej anëtarëve të Bashkimit Ekonomik për shërbimet/zërat e marrë përsipër sipas ofertës. Anëtarët e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik do të mbajnë përgjegjësi individuale (jo solidare) për mospërmbushjen e detyrimeve ndaj Posta Shqiptare sh.a.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Shërbimi i marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit dhe reagimi me grup të gatshëm në të gjitha Filialet e Degët, e Postës Shqiptare

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj

Shperndarja dhe instalimi :

Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi per 12 Muaj	Çmimi Total	Afati
2.	Shërbimi i marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit.	384			12 muaj
	T O T A L I	384			

Shuma e përgjithshme e zyrave postare të pajisura me sisteme alarmi:

- J. SH.R.S.F-ja, të disponojë qendër operative me shërbim 24 orësh, për marrjen dhe verifikimin me grup të gatshëm, të sinjaleve të sistemit të alarmit të instaluar në objektet e Postës Shqiptare sh a.
- K. SH.R.S.F-ja, të ketë të instaluar në qendrën operative të saj, qendrën e radiondërlidhjes.
- L. Në qendrën operative, përveç pajisjeve të mësipërme, të ketë të instaluar qendër kompjuterike për marrjen e sinjaleve të sistemeve të alarmit në rrugë valore.
- M. Në qendrën kompjuterike të disponojë: antenë marrëse me pajisjen përkatëse, kompjuter (njësi+monitor), program kompjuterik për marrjen e sinjaleve të alarmit (**të instaluar në kompjutër dhe funksional me objekte të tjerë**), printer për printim automatik dhe pa ndërprerje të çdo ngjarjeje (sinjali alarmi).

-
- N. Të sigurojë funksionimin 24 orë dhe mbajtjen në gadishmëri, të pajisjeve radio të instaluara në sistemet tona të alarmit, si dhe të qendrës kompjuterike.
 - O. Të sigurojë printim permanent të ngjarjeve (sinjaleve të alarmit) në qendrën kompjuterike dhe të vendosë në dispozicion të Postës, kur kjo e shihet të arsyeshme.
 - P. SH.R.S.F-ja, të ketë grup të gatshëm 24 orë, të paisur me automjetet të posaçëm, armatim personal, dhe pajisje radiondërlidhje gjithëkrah sipas ligjit nr ligj Nr. 75/2014 “ Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Udhëzimit nr.130 datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike” të atashuar pranë qendrës së firmës, dhe në Filialet Postës për të ndërhyrë në kohë sa më të shpejtë në çdo Filial, Degë apo zyrë të Posta Shqiptare sh a.
 - Q. SH.R.S.F-ja, të ketë sistem ndërlidhje eficient në të gjithë territorin ku zhvillon aktivitetin Posta Shqiptare sh.a
 - R. Veprimet e Grupit të Gatshëm në vendngjarje do të jenë në mbrojtje të jetës së punonjësve, të vlerave monetare e të aseteve të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., duke neutralizuar, bllokuar, ndjekur e ndaluar (*arestuar*) elementin kriminal. Veprimet operative dhe përdorimi i armëve luftarake do të kryhen në përputhje me Ligjin nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Ligjin nr.72, datë 10.07.2014, “Për përdorimin e armëve të zjarrit”.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Qëllimi i kësaj procedure prokurimi është përmbushja e njëres prej pikave kryesore të misionit të shoqërisë që ka të bëjë me garantimin e sigurisë nëpërmjet reagimit me grupe te gatshme ne raste rreziku.

Zhvillimi i kësaj procedure është një detyrim ligjor i Posta Shqiptare sh.a në zbatim të Ligjit “Per masat shtese te sigurise publike” si dhe Udhezimit Nr. 633, datë 6.11.2018 “Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo të vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre”.

Detyrat: **Te percaktuara ne Shtojca 6 te DST-ve (Specifikimet Teknike)**

Shpërndarja: **E percaktuar ne Shtojca 6 te DST-ve (Specifikimet Teknike)**

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Te percaktuara ne Shtojca 6 te DST-ve (Specifikimet Teknike)**

Periudha e shërbimit është **për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarik.**

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

-
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar të jetë jo më pak se 95% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar Shërbime të ngjashme, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik fitues duhet të jetë pajisur me License të ushtrimit të aktivitetit të kategorisë 1.3.A “Për ruajtjen e sigurimit e objekteve dhe pronave” në përmbushje të plotë të detyrimeve që përcakton Ligji Nr.75/2014 “Për Shërbimin privat të Sigurisë Fizike”.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatë të Titullarit dhe Drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi të 12 (dymbëdhjetë) qarqet e Shqipërisë.

2.3.5. Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të **Qendrës së Menaxhimit të Shërbimeve (QMSH) për qarkun ku subjekti ka selinë dhe Aktin e Miratimit të Zyres së Menaxhimit të Shërbimeve (ZMSH) të SHPSF**, për të 12 Qarqet e Shqipërisë sipas udhëzimit të Ministrisë të Punëve të Brendshme nr. 150 datë 16.08.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij minimalisht 10 (dhjetë) punonjës shërbimi për çdo qark. Për këtë operator ekonomik duhet të paraqesë vërtetim performancë nga

Drejtorite e Policise se Qarkut konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Ky vertetim duhet të përmbajë informacionin dhe opinionin që disponojnë Drejtorite e Policisë së Qarkut sa më poshtë për:

- a) Qendra e kontrollit të shërbimit.
